



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

---

**Legjislatura V**  
**Sesioni pranveror**

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike  
Mbledhja nr. 46  
Prishtinë, më 5 prill 2017, në orën 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-204

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Faton Topalli, Ali Sadriu, Hajdar Beqa, Synavere Rysha, Naim Fetahu, Bali Muharremaj, Abdyl Ymeri dhe Enver Hoti.

**Mungoi:** Fikrim Damka

**Pjesëmarrësit tjerë:** Zukë Zuka, ZKA, Jana Seiclet dhe Johannes Kockeis, GIZ-i, Jeta Rafuna, GPLDK-ja, Blerta Aliu, nga KDI-ja, Rrahman Ramaj, BIRN-i.

**Stafi Mbështetës i Komisionit:** Antigona Ibraj, koordinatore e Komisionit, Mehmet Simnica, zyrtar i fushës për ekonomi dhe Mentor Hyseni, GIZ-i.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 15.3.2017 dhe 22.3.2017;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit përfundimtar për Projektligjin nr.05/L-122, për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike;
4. Të ndryshme.

*Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.*

**1. Miratimi i rendit të ditës**

*Kryetari konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

**2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 15.3.2017 dhe 22.3.2017**

*Kryetari konstatoi se procesverbali, i mbledhjes së mbajtur më 15.03.2017 dhe 22.03.2017, u miratua pa vërejtje.*

### **3. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit përfundimtar për Projektligjin nr. 05/L-122, për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike**

**Faton Topalli, kryetar,** theksoi se do të diskutojmë sot për Projektligjin për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, përkatësisht raportin përfundimtar. Komisionet e përhershme, përkatësisht Komisioni i Buxhetit ka dorëzuar dy amendamente për të cilat KMFP-ja nuk është pajtuar edhe në kohën kur kemi punuar për raportin fillestar me amendamente. Komisioni për Buxhet dhe Financa, ka propozuar që rrogat e auditorëve të brendshme të rregullohen sipas legjislacionit për Shërbimin Civil. Ne kemi propozuar që pagat e Auditorëve të Brendshëm të jenë në nivel të njëjtë me pagat e Auditorëve të ZKA-së. Duke dashur ta ruajmë pavarësinë e auditorëve të brendshëm që rrogat e tyre të jenë në harmoni me rrogat e auditorëve të jashtëm. Unë propozoj që të shkojmë me dy propozimet për seancë plenare dhe pastaj seanca le të vendosë me shumicë votash. Me këtë hapi diskutimin.

**Ali Sadriu,** mbështeti komisionin për dërgimin e dy propozimeve në seancë, për arsye se këto janë propozimet më të mira të mundshme që kemi mundur ne si komision ti bëjmë. Po ashtu, kërkoi nga deputetët që edhe në seancë të angazhohemi që këto të miratohen.

**Abdyl Ymeri,** theksoi se ne si komision kemi bërë më të mirën të mundshme dhe theksoi se si komision duhet të mbrojmë propozimin tonë në Kuvend pastaj Kuvendi do të japë fjalën e fundit në këtë aspekt.

**Synavere Rysha,** po ashtu mbështeti dërgimin e dy propozimeve në seancë, edhe pse theksoi se nuk është punuar mjaftueshëm në këtë aspekt, sepse është dashur më shumë të mbështetet amendamenti i KMFP-së sepse ka qenë më i qëndrueshëm, dhe se ky amendament është bërë që të u ipet më shumë pavarësi auditorëve të brendshëm.

**Faton Topalli, kryetar,** tha se dy propozimet do të dërgohen në seancë, ndërsa pasi i hodhi në votim, mori mbështetjen e të gjithë deputetëve.

#### *Përfundim*

*KMFP-ja, miratoi raportin përfundimtar për Projektligjin nr. 05/L-122 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike. Të njëjtin vendosi ta adresojë për seancë plenare.*

### **4. Te ndryshme.**

**Ali Sadriu,** kërkoi që shqyrtimi i Projektligjit për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike të mos bëhet në seancën e radhës, me arsyetim se nuk mund të marrë pjesë në këtë seancë, të datës 11.4.2017.

**Faton Topalli, kryetar**, pasi që nuk pati të interesuar për diskutim e mbylli takimin.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30

E përgatiti:  
Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

---

Faton Topalli